



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 176

Tiranë – E hënë, 5 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11745, datë 24.9.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12335
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 764, datë 30.9.2020	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, për Njësinë Administrative Qendër Ersekë, të pasurisë 685, zona kadastrale 3510..... 12335
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 30.9.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i mikrohapësirave publike, sheshi ‘Selita’”, Tiranë..... 12338
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 766, datë 30.9.2020	Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve buxhetore, në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë..... 12340
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 30.9.2020	Për dhënien e kontributit financiar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, për blerjen e teksteve shkollore..... 12340
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 30.9.2020	Për përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë..... 12341
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 30.9.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkimit”..... 12341
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 773, datë 30.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 594, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, të ndryshuar.... 12342
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 30.9.2020	Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Katarit për Zhvillim, për financimin e rikonstruksionit të dy shkollave dhe një kopshti, në Bashkinë Tiranë..... 12343

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 30.9.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe rforcimin e hidrovorit të Durrësit.....	12348
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 30.9.2020	Për lirim dhe emërim në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.....	12349
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 23, datë 28.9.2020	Për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar.....	12349
Urdhër ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 213/1, datë 1.9.2020	Për marrjen e masave të veçanta nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, për aplikuesit dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.....	12349
Urdhër ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 266/1, datë 1.9.2020	Për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.....	12350
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 294, datë 29.9.2020	Për delegim kompetence.....	12352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 149, datë 10.9.2020	Mbi miratimin e “Programit të përputhshmërisë rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga Tap-AG në bazë të “Opinionit të përbashkët përfundimtar/Final joint opinion” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP.....	12352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 150, datë 10.9.2020	Mbi disa shtesa në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105/2020, miratimin e oficerit të përputhshmërisë (ZP) së TAP dhe kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë.....	12355
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 151, datë 18.9.2020	Mbi zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., nr. 306, seria FK15, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 105, datë 18.8.2015.....	12356
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 152, datë 18.9.2020	Mbi zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Mobigas Alba” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).....	12357
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 153, datë 18.9.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., “Për barrësimin dhe hipotekimin e aseteve të shoqërisë ‘M.T.C. Energy’ sh.p.k. në HEC ‘Radovë’, në favor të ‘Alpha Bank’, në zbatim të kontratës së huas me ‘Alpha Bank’ sh.a. nr. 125 rep., nr. 32 kol, datë 9.1.2020”.....	12359
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 154, datë 18.9.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamican” me kapacitet të instaluar 1860 kw.....	12366
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Anri Maliqaj.....	12367

**DEKRET**

Nr. 11745, datë 24.9.2020

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, germa “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Besart Brahim Zogaj
2. Esmira Junuz Bećović (Beqović)
3. Mefat Hajdat Shehu
4. Gazmend Cen Avdylaj
5. Özgün Memduh Tektürk
6. Hamit Ahmet Başbüyük
7. Raghad Mohamed (Mohammed) Faraj (Farag) Khalleefah (Khalleefah)
8. Fetullah Alihaydar Yigitler
9. Ahmed Ali Abdelmeguid Hussein
10. Rawda Ahmed Ali Abdelmeguid Hussein
11. Omar Ahmed Ali Abdelmeguid Hussein
12. Naim Halit Morina
13. Kemajl Shaban Berisha
14. Mustafa İlker Sami Razbonyali
15. Anna Domenico Nreu (Miele)
16. Tounis Mohammed Abraheem
17. Feim Ali Hoxha
18. Lidiya Simon Dulaj Skeli (Dulaj)
19. Tiara Marjan Skeli

Neni 2

Ku dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 764, datë 30.9.2020

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KOLONJË, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE QENDËR ERSEKË,
TË PASURISË 685,
ZONA KADASTRALE 3510**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “ç”, e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, për njësinë administrative Qendër Ersekë, të pasurisë 685, zona kadastrale 3510, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t'u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 247, datë 27.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Ersekë, të Qarkut të Korçës”.

3. Ngarkohen Bashkia Kolonjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)


[illegible]



HARTE KADASTRALE (Fragment)

BASHKIA KOLONJE KRYETAR Erion ISAI Pergjegjës: Specialist Ing. Topograf: inxh. Muharem LARZARI nr. lic. K. 1601/1	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: 3510 NR. I PASURISË: 685 Vol 8 Fq 15 INDEKSI I HARTËS: K-34-126-(231-A);(231-B);(231-C);(231-D) SHKALLA: 1 : 14 000 ADRESA E PASURISË: Bashkia Kolonje Fshati Starje Rr _____ P/G _____ SH _____ K _____ AP _____ B. KUFIZIMET C. PRONARI D. SIPERFAQE SHTET Sip. = 1020711 m² [102.0711 ha] VERI: _____ JUG: _____ LINDJE: _____ PERENDIM: _____ Data: 5.6.2020 Ora: 11 e 56
--	---

Projektimi: KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE
Sistemi koordinativ: [KRGJSH]



**VENDIM****Nr. 765, datë 30.9.2020****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I MIKROHAPËSIRAVE
PUBLIKE, SHESHI ‘SELITA’”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i mikrohapësirave publike, sheshi ‘Selita’”, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “truall”, me vlerë 16 376 556 (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 16 376 556 (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i

miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe**



LISTA E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I MIKROHAPËSIRAVE, SHESHI ‘SELITA’” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale Truall m ²	Sip. truall i prekur m ²	Çmimi truall lekë/m ²	Vlera truall e prekur (lekë)	Vlera truall (lekë)	Konfirmim i Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Jug	Shënime në kartelë
1	Bashkëpronarët Ylli, Bogdani, Biba	Truall	8260	3/142	320.0	320.0	30,783	9,850,560	9,850,560	Konfirmohet me shkresën nr. prot.579/1, datë 12.6.2019 dhe rikonfirmohet me shkresën nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020	Në seksioni E të kartelës ka shënimin: Ka ndërtim pa leje
2	Bashkëpronarët Ylli, Bogdani, Biba	Truall	8260	3/202	252.80	212.0	30,783	6,525,996	6,525,996	Konfirmohet me shkresën nr. prot.579/1, datë 12.6.2019 dhe rikonfirmohet me shkresën nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020	Në seksioni E të kartelës ka shënimin: Ka ndërtim pa leje
SHUMA						532.00			16,376,556		

Shënime:

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.

2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste janë bazuar në të dhënat e marra nga konfirmimi i Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Jug, me shkresat nr. prot. 579/1, datë 12.6.2019, nr. prot. 579/3, datë 11.7.2019 dhe nr. prot. 4985/1, datë 22.5.2020.

**VENDIM****Nr. 766, datë 30.9.2020**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH
NDËRMJET PROGRAMEVE
BUXHETORE, NË BUXHETIN E VITIT
2020, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturrës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturrës dhe Energjisë, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, zëri “Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm”, pakësohet fondi prej 179 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milionë) lekësh;

b) në programin buxhetor 06220 “Menaxhimi i mbetjeve urbane”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, zëri “Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm”, shtohet fondi prej 179 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturrës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturrës së Mbetjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 768, datë 30.9.2020**

**PËR DHËNIEN E KONTRIBUTIT
FINANCIAR NGA KËSHILLI I
MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PËR KËSHILLIN
KOMBËTAR SHQIPTAR NË SERBI, PËR
BLERJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e kontributit financiar, në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) euro ose kundërvlerën e saj në lekë, për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, për t'u përdorur për blerjen e teksteve shkollore për shkollat shqipe.

2. Kundërvlera në lekë e shumës së sipërpërmendur të transferohet në formën e transfertës në llogari të përfituesit, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në programet buxhetore “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, “Sporti” dhe “Rinia”.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**VENDIM****Nr. 769, datë 30.9.2020****PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT
MAKSIMAL TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOHSHE PËR
MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri maksimal i punonjësve arsimorë me kontratë të përkohshme ose me kontratë me kohë të pjesshme, për vitin shkollor 2020–2021 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është jo më shumë 1 000 (një mijë) punonjës.

2. Punonjësit arsimorë me kontratë të përkohshme ose me kontratë me kohë të pjesshme rekrutohen nga portali “Mësues për Shqipërinë” për sistemin arsimor parauniversitar (arsimi bazë, gjimnazi dhe arsimi i mesëm i orientuar), me qëllim përballimin e nevojave për punonjës arsimorë shtesë gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, për vitin shkollor 2020–2021.

3. Shpërndarja e numrit të punonjësve arsimorë me kontratë të përkohshme ose me kontratë me kohë të pjesshme, në varësi të nevojave të zyrave vendore të arsimit parauniversitar, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Pagesa e punonjësve arsimorë me kontratë të përkohshme ose me kontratë me kohë të pjesshme kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, në varësi të kohës së punës së kryer.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2020, i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në programet buxhetore

“Arsimi bazë” dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****VENDIM****Nr. 772, datë 30.9.2020****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 719, DATË 12.10.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MENAXHIMIN E KAPACITETEVE TË
PESHKIMIT TREGTAR DHE DISA
RREGULLIME TË MËNYRËS SË
FUNKSIONIMIT TË REGJISTRIT TË
ANIJEVE TË PESHKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 2, 30, 101, pika 2, dhe 119, pika 2, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun II, të vendimit nr. 719, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i lejeve të peshkimit tregtar profesional, për të gjitha format dhe llojet e këtij peshkimi, deklarohet i mbyllur. Me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e resurseve të pelagjikeve të vegjël, për anijet që janë të lejuara për të dyja format e peshkimit së bashku, tërheqëse fundore dhe tërheqëse pelagjike, subjekti i peshkimit ka të drejtë të ndryshojë lejen e peshkimit duke kaluar vetëm në rrjeta tërheqëse fundore.”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1. Kalimi nga lejet e peshkimit për të dyja format e peshkimit, në rrjeta tërheqëse fundore dhe në rrjeta tërheqëse pelagjike, në formën e peshkimit



vetëm tërheqëse fundore, bëhet nga ministria përgjegjëse për peshkimin.

1/2. Numri maksimal i lejeve të peshkimit tregtar artizanal bregdetar përcaktohet me urdhër nga ministri përgjegjës për peshkimin, në zbatim të planit të menaxhimit të peshkimit dhe të planit të zbatimit të peshkimit.

Për numrin e lejeve të peshkimit tregtar artizanal, të cilat mund të jepen në zonat e mbrojtura të kategorive IV, V dhe VI, të merret pëlqimi dhe nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.”

3. Pikat 2, 3, 4 dhe 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Të gjitha anijet e peshkimit të regjistruara në regjistrin e anijeve të peshkimit dhe të pajisura me numër regjistri (NFR), por që iu ka mbaruar afati i vlefshmërisë së lejes së peshkimit dhe nuk e kanë rinovuar atë, kanë të drejtë të aplikojnë për rinovimin e lejes deri në datën 5 dhjetor 2020.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Inspektorati i Peshkimit pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, njofton, sipas procedurave të njoftimit të Kodit të Procedurave Administrative, subjektet e peshkimit, pronarët ose administratorët e tyre, të cilëve u ka përfunduar afati i vlefshmërisë, nuk e kanë rinovuar ose që nuk do të rinovojnë lejen e peshkimit për fillimin e procedurave të nxjerrjes nga flota e peshkimit të anijeve të peshkimit në pronësi ose në administrim prej tyre.

4. Në rast se subjektet e peshkimit, pronarët ose administratorët e anijeve të peshkimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nuk deklarojnë vullnetin për të vazhduar aktivitetin e peshkimit dhe të rinovojnë lejen e peshkimit, ministria përgjegjëse për peshkimin bën daljen përfundimtare të anijes nga flota e peshkimit dhe bën të pavlefshëm numrin e regjistrin (NFR) të anijes së peshkimit.

7. Subjektet e peshkimit, në aplikimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për rinovimin e lejes së peshkimit, dorëzojnë edhe një kopje të lejes dhe të aktit të miratimit të vjetër, në rastet kur anija ka qenë e pajisur me leje peshkimi të vlefshme.”

4. Pika 8 shfuqizohet.

5. Pikat 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“9. Me mbylljen e numrit të lejeve të peshkimit tregtar profesional dhe artizanal, pas datës 5 dhjetor

2020, ministria përgjegjëse për peshkimin njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila refuzon kërkesën e subjekteve të peshkimit për hyrjen e anijeve të peshkimit tregtar profesional, përveç rastit të parashikuar në pikën 10, të këtij kreu.

10. Hyrja në flotën e peshkimit e një kapaciteti të ri peshkimi bëhet vetëm si zëvendësim me një anije me tonazh dhe fuqi motorike më të vogël ose të barabartë i një anijeje me leje të vlefshme peshkimi ose si zëvendësim i një anijeje peshkimi të mbytur, e cila ishte e pajisur me një leje të vlefshme peshkimi. Në këtë rast, subjekti i peshkimit të anijes së mbytur, pronari ose trashëgimtarët e tij aplikojnë për t'u pajisur me leje të re peshkimi.”

6. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Në aktin e miratimit të lejes së re të peshkimit, për anijen e peshkimit zëvendësuese vendoset një numër regjistri (NFR) i ri duke u specifikuar qartësisht që është zëvendësim i anijes me numrin e regjistrin (NFR) të mëparshëm. Anija zëvendësuese nuk konsiderohet si hyrje e re në peshkim.”

II. Ngarkohet ministria përgjegjëse për peshkimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 773, datë 30.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 594, DATË 9.10.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E
KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË
KËSHILLIT DREJTUES TË FONDIT
SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E
DIASPORËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 594, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

- Znj. Adea Pirdeni emërohet në vend të znj. Fjoralba Caka, si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për drejtësinë, për pjesën e mbetur të mandatit, sipas pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 32/2018.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 774, datë 30.9.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT TË
KATARIT PËR ZHVILLIM, PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT
TË DY SHKOLLAVE DHE NJË
KOPSHTI, NË BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Katarit për Zhvillim, për financimin e rikonstruksionit të dy shkollave dhe një kopshti, në Bashkinë Tiranë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

FONDI I KATARIT PËR ZHVILLIM

MARRËVESHJE GRANTI
NË LIDHJE ME FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT PËR 2 SHKOLLA
DHE 1 KOPSHT NË TIRANË NDËRMJET
FONDIT TË KATARIT PËR ZHVILLIM
(“PALA E PARË”) DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (“PALA E DYTË”)
DATË GUSHT 2020

Kjo Marrëveshje Granti (“Marrëveshja”) ndërmjet:

Fondit të Katarit për Zhvillim, një korporatë publike nga Katari, e themeluar sipas rregullave në bazë të ligjit nr. 19, të vitit 2002, me seli të regjistruar në adresën: Laffan Tower, West Bay, Doha, Qatar (Katar), e përfaqësuar në këtë Marrëveshje nga (z. _____), në cilësinë e tij si (_____), dhe nënshkrues i autorizuar

dhe

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar në këtë Marrëveshje nga z. Arben Ahmetaj, në cilësinë e tij si (ministër shteti për rindërtim) dhe nënshkrues i autorizuar.

Në këtë Marrëveshje, palët e para dhe të dyta mund të referohen gjithashtu individualisht si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.

Preambulë

Në zbatim të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e caktuara secilës prej tyre, si më poshtë:

- Pala e parë: Fondi i Katarit për Zhvillim.
- Pala e dytë: Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

- Përfituesi/Autoriteti Zbatues: Bashkia e Tiranës.

- Projekti: Projekti i mbuluar nga kjo Marrëveshje.

- Granti (Grant): Kostoja e projektit dhe shuma që do të ofrohet nga Pala e Parë për projektin që arrin shumën e vetëm pesë milionë dollarë amerikanë (5,000,000 dollarë amerikanë).

Specifikimet

Duke pasur parasysh se Pala e Parë është themeluar nga Shteti i Katarit sipas ligjit nr. 19, të vitit 2002, me qëllim asistimin e shteteve arabe dhe



shteteve të tjera në zhvillim për qëllime të zhvillimit të ekonomive të tyre dhe zbatimit të programeve dhe projekteve për zhvillim;

Duke pasur parasysh se Pala e Parë kërkon t'i japë Palës së Dytë një kontribut që do të shfrytëzohet për rikonstruksionin e 2 shkollave dhe 1 kopshti në Tiranë brenda ambienteve të Palës së Dytë ("Projekti").

Si rrjedhojë, me anë të kësaj Marrëveshjeje, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Preambulë

Preambula e mësipërme përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2 Qëllimi i projektit

Kjo Marrëveshje është lidhur nga Palët, me synim arritjen e qëllimeve të Projektit që është rikonstruksioni i 2 shkollave dhe i 1 kopshti, siç renditen më poshtë:

1. Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Lasgush Poradeci", për një zonë totale të ndërtuar (8000 m²).

2. Rikonstruksioni i shkollave 9-vjeçare dhe të mesme "15 Shtatori" ("Pezë e Madhe"), për një zonë totale të ndërtuar (3632 m²).

3. Rikonstruksioni i kopshtit dhe çerdhes nr. 42, për një zonë totale të ndërtuar (1875 m²). ("Projekti").

Neni 3 Shuma e kontributit dhe disbursimi i tij

3.1. Pala e parë bie dakord ti japë Palës së Dytë vetëm pesë milionë dollarë amerikanë (5,000,000 dollarë amerikanë) ("Granti") që do të shfrytëzohet për realizimin e qëllimeve të Projektit. Granti do të shfrytëzohet për kostot dhe shpenzimet e Projektit siç miratohet nga Pala e Parë, duke përfshirë por pa u kufizuar te sa më poshtë:

a) 4,750,000 dollarë amerikanë kosto për projektet mbi rikonstruksionin e 2 shkollave dhe 1 kopshti;

b) tarifa 250,000 dollarë amerikanë, për konsulentët dhe këshilltarët që mund të angazhohen nga Pala e Parë në lidhje me Projektin

(d.m.th. kostot teknike, financiare, ligjore dhe ose të menaxherit të projektit) të shoqëruara me ceremoninë e hapjes zyrtare dhe tarifat e administrimit të Palës së Parë;

c) tarifa shtesë që mund të miratohet nga Pala e Parë për përfundimin e Projektit.

3.2 Granti do të disbursohet sipas propozimit të buxhetit të paraqitur dhe të miratuar nga Pala e Parë. Nëse një propozim buxheti nuk rishikohet dhe miratohet ndryshe nga Pala e Parë, kjo e fundit nuk do të ketë detyrim për disbursimin e ndonjë pjese të Grantit.

3.3 Një tarifë (250,000 dollarë amerikanë) e Grantit i alokohet Palës së Parë për shlyerjen dhe auditimin e kostove të ngjashme të Palës së Parë për menaxhimin e një projekti të tillë siç përmendet më lart.

3.4 Granti, kostot dhe shpenzimet e caktuara në dollarë amerikanë, e cila është monedha e llogarisë dhe metoda e pagesës në lidhje me Projektin. Çdo ndryshim në vlerën e Projektit si rezultat i ndryshimeve në kursin e këmbimit, do të mbulohet nga Pala e Dytë.

3.5 Të gjitha taksat, shumat, detyrimet, tatimet, pagesat, tarifat, zbritjet, shumat e mbajtura ("Taksa") që mund të vendosen nga autoritetet përkatëse në lidhje me Projektin dhe ekzekutimi i tij do të merren përsipër nga Pala e Dytë në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi. Në çdo rast që ndonjë autoritet përkatës vendos taksën ndaj Palës së Parë, Pala e Dytë merr përsipër të dëmshpërblejë Palën e Parë dhe të gjitha palët e interesuara të marrëveshjes si konsulentët dhe kontraktuesit, për çdo taksë.

Neni 4 Detyrat dhe detyrimet e Palës së Parë

Pala e Parë:

Transferon shumat sipas Grantit, totali i të cilave nuk duhet të tejkalojë pesë milionë dollarë amerikanë (5,000,000 USD) drejtpërdrejt në llogaritë e ndonjë prej ofruesve të shërbimeve (kontraktuesit/konsulentët), me kusht që çdo dhe të gjitha pagesat e kryera në bazë të kësaj Marrëveshjeje të jenë miratuar paraprakisht nga Pala e Parë.

4.1 Udhëzimet e pagesave:

4.1.1 Granti dhe gjithçka që lidhet me Grantin do të caktohen në dollarë amerikanë; dhe dollari



amerikan është monedha e llogarisë dhe mënyra e pagesës. Në rast të ndryshimit të vlerës së projektit si rezultat i një ndryshimi në kursin e këmbimit, Pala e Dytë do të mbulojë diferencën e këtij ndryshimi;

4.1.2 Pagesat nga Pala e Parë në llogarinë e **Projektit** i nënshtrohen çdo llogarie të miratuar nga Pala e Parë, dhe do të kryhen në fund të secilës prej fazave të ndërtimit dhe objektivave të përcaktuara nga Pala e Parë, ndërsa kërkesat për pagesa ose kërkesat për detyrime financiare të dërguara nga kontraktuesi, konsulenti dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve për inxhinierin dhe Palën e Dytë/Përfituesin për auditim, do t'i dorëzohen dhe referohen Palës së Parë për miratim dhe pagesë në llogarinë e ofruesve të shërbimeve; dhe

4.1.3 Pala e Parë ka të drejtë të rishikojë të gjitha dokumentet, pasqyrat bankare, faturat, raportet, rekomandimet dhe korrespondencat e tjera, printimet dhe të dhënat në lidhje me objektin e Marrëveshjes.

Neni 5

Detyrat dhe detyrimet e Palës së Dytë

Pala e Dytë, nëpërmjet Përfituesit:

5.1 Kryen të gjitha procedurave e nevojshme dhe merr miratimet e nevojshme për zbatimin e Projektit, duke përfshirë por pa u kufizuar në marrjen e licencave dhe lejeve të nevojshme për ndërtimin dhe funksionimin e projektit;

5.2 U siguron konsulentëve dhe kontraktuesve sheshin e ndërtimit/projektit, pa asnjë pengesë, sipas kërkesave për zbatimin e Projektit dhe garanton mënyra për hyrje në sheshin e ndërtimit;

5.3 Të gjitha taksat, tatimet, detyrimet, tarifat, tarifatat, zbritjet, shumatat e mbajtura ("Taksa") që mund të vendosen nga autoritetet përkatëse në lidhje me Projektin dhe ekzekutimi i tij do të merren përsipër nga Pala e Dytë në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi. Në çdo rast që ndonjë autoritet përkatës vendos taksën ndaj Palës së Parë, Pala e Dytë merr përsipër të dëmshpërblejë Palën e Parë dhe të gjitha palët e interesuara të marrëveshjes si Konsulentët dhe Kontraktuesit, për çdo taksë;

5.4 Pala e Dytë që mbulon shumë që tejkalon koston e ndërtimit të alokuar për Projektin, siç përmendet në pikën 3.1(a).

Neni 6

Menaxhimi i Projektit dhe monitorimi i ekzekutimit të tij

6.1 Pala e Parë dhe Përfituesi do të menaxhojnë projektin si më poshtë:

6.1.1 Përcaktimi i prioritetëve dhe objektivave kryesore të punimeve në koordinim me Përfituesin;

6.1.2 Pala e Parë do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e procedurave të tenderit që përfshin hapjen e ofertave teknike dhe financiare të zyrave të këshillimit dhe kontraktuesve, rishikimin, vlerësimin dhe dhënien e tyre;

6.1.3 Pala e Parë do të jetë përgjegjëse për miratimin dhe nënshkrimin e konfirmimeve me shkrim për dhënien e kontratës dhe të gjitha vërtetimet e pagesave për tenderuesit e suksesshëm dhe ofruesit e shërbimeve;

6.1.4 Pala e Parë ka të drejtë të caktojë një konsulent teknik (Inxhinieri) për të menaxhuar punimet e kërkuara dhe për të përgatitur raporte teknike dhe financiare për miratim nga Pala e Parë;

6.1.5 Pala e Parë mund të emërojë konsulentë inxhinierikë, konsulentë financiarë dhe ligjorë, siç e çmon të nevojshme;

6.1.6 Çështjet e përgjithshme për të garantuar progresin e duhur të të gjitha punëve në lidhje me projektin dhe për të verifikuar që detyrat dhe detyrimet e Palëve janë përmbushur siç duhet dhe në mënyrë të duhur;

6.1.7 Pala e Parë do të jetë kompetente për të gjitha çështjet dhe masat në lidhje me Projektin dhe menaxhimin e tij dhe monitorimin e shfrytëzimit dhe ekzekutimit të Projektit;

6.1.8 Pala e Parë mund të caktojë një njësi ekzekutive ("Njësia Ekzekutive") në lidhje me projektin, i cili do të menaxhojë dhe kryejë punimet sipas udhëzimeve dhe vendimeve të Palës së Parë të projektit dhe politikave, procedurave dhe praktikave të qeverisjes të Palës së Parë;

6.1.9 Pala e Parë, pas nënshkrimit të konfirmimit me shkrim për dhënien e kontratës, do të njoftojë Përfituesin që të nënshkruajë kontratat dhe marrëveshjet e ndërtimit;

6.1.10 Përfituesi do të jetë përgjegjës që të rishikojë, komentojë dhe vleftësojë certifikatat e pagesave të kontraktuesve, të cilat do t'i dorëzohen dhe referohen Palës së Parë për miratim dhe pagesë në llogaritë e ofruesit të shërbimeve.



6.1.11 Për të optimizuar interesin e projektit, Pala e Dytë Përfituesi lehtëson procedurat në koordinim me subjektet vendore të lidhura dhe të gjitha departamentet ministrore dhe autoritetet e tjera të përfshira në projekt, në mënyrë që të garantojë progresin e Projektit dhe koordinimin e zbatimit të tij. Përfituesi do të trajtojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e projektit nëpërmjet Drejtorisë së Zbatimit të Investimeve të Huaja, duke ofruar një ekip me përvojë inxhinierike dhe teknike të pranueshëm sipas kërkesave të Palës së Parë.

6.1.12 Pala e Dytë, nëpërmjet Përfituesit, do të eliminojë çdo pengesë që pengojnë ekzekutimin e projektit në kohën e duhur, sipas kontratave dhe marrëveshjeve të nënshkruara, me qëllim shmangien e ndonjë rritjeje të kostove.

Neni 7

Mekanizmi i tërheqjes nga Granti

7.1 Granti nuk mund të përdoret për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara para datës së kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës së Parë;

7.2 Tërheqja nga Granti do të bëhet në bazë të shlyerjes së shumave të kërkueshme deri në datën e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, për konsulentët, kontraktuesit dhe furnitorët, me kusht që shuma të tilla të miratohen nga Pala e Parë dhe me kusht që Pala e Parë të jetë e bindur për autenticitetin dhe saktësinë e ekstrakteve; dhe

7.3 Në bazë të paragrafit pararendës, Pala e Parë do të pranojë nxjerrjen e pagesave nga bilanci i grantit, në bazë të ekstrakteve të përmendura në paragrafin pararendës.

Neni 8

Vizibiliteti

8.1 Përfituesi/Kontraktimi për të lejuar kontraktuesin që të instalojë një tabelë të qartë në sheshin e ndërtimit me emrin dhe logon e plotë të QFFD-së dhe rolin e financuesit të Projektit për kohëzgjatjen e plotë të periudhës së ndërtimit.

8.2 Pas përfundimit të Projektit, me një mesazh të miratuar nga QFFD-ja, Pala e Dytë do të ndërtojë 2 pllaka të përhershme; një jashtë hyrjes kryesore të godinës dhe një pllakë tjetër brenda me madhësinë e konfigurimit horizontal të CM-së (100 * 70).

8.3 Pala e dytë duhet të nxjerrë dy njoftime për shtyp, një në fillim të Projektit dhe një tjetër në fund. Të dyja njoftimet për shtyp duhet të përfshijnë një deklaratë të QFFD-së dhe të miratohen nga komunikimi i QFFD-së përpara publikimit.

8.4 Pala e dytë duhet të organizojë dy mundësi për mbulimin e mediave lokale. E para është gjatë ndërtimit dhe e dyta gjatë lançimit të Projektit. Të dyja mundësitë duhet të përfshijnë një përfaqësues nga Katari.

8.5 Pala e dytë duhet të njoftojë lajmet e njoftimit për shtyp në kanalet e përshtatshme të mediave sociale.

Neni 9

Përgjegjësia

Asnjëra prej palëve nuk është përgjegjëse ndaj Palës tjetër për çdo lloj humbjeje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me përjashtim të rasteve kur humbja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë është rezultat i pakujdesisë flagrante, mashtrimit ose veprave të tjera penale të Palës tjetër.

Neni 10

Efekti detyrues

Kjo Marrëveshje do të jetë detyruese për të gjitha Palët dhe çdo shkelle e ndonjë prej termave dhe kushteve të saj do të sjellë përgjegjësi ligjore. Palët bien dakord të hyjnë në ndonjë marrëveshje të mëtejshme ligjërish detyruese, e cila çmohet e nevojshme për të realizuar ndërtimin e Projektit dhe për të garantuar qeverisjen e duhur të Grantit për Palën e Parë.

Neni 11

Ndryshimet dhe shtesat

Ndryshimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje nuk konsiderohen të sakta, përveç nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga nënshkruesit e autorizuar, dhe duke pasur rekurs dhe këshillim me personin juridik. Ndryshimet dhe shtesat e tilla i dorëzohen nënshkruesve të autorizuar para miratimit të tyre.



Neni 12

Raportet dhe deklaratat publike

Njoftimi i Palëve të kësaj Marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm nëse bëhet me shkrim dhe dërgohet me postë të regjistruar dhe nga korrieri ndërkombëtar në adresën dhe detajet e kontaktit të dhëna në nenin 13.

Palët kanë përcaktuar mundësinë e shkëmbimit të informacionit për aspektet e ndërsjella të projektit sipas legjislacionit aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Shtetin e Katarit dhe të pranimit të detyrimeve të mos-zbulimit të informacionit konfidencial, duke përfshirë sekretet shtetërore, sekretet tregtare dhe të dhëna të tjera të mbrojtura sipas legjislacionit aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Shtetin e Katarit. Palët gjithashtu bien dakord t'i japin vëmendjen e duhur legjislacionit përkatës në fuqi të Shtetit të Katarit dhe Republikës së Shqipërisë në lidhje me zbulimin e informacionit konfidencial.

Në lidhje me deklaratat publike, Pala e Dytë, në çdo kohë koordinon me Palën e Parë çdo deklaratë publike, si dhe cilindo nga prezantimet publike dhe private për shtyp. Pala e Dytë bie dakord që koordinimi midis Palëve është thelbësor në lidhje me përmbajtjen, mjetet dhe rëndësinë e çështjeve përkatëse të komunikimit. Si rrjedhojë, Pala e Dytë pajtohet me udhëzimet e komunikimit në lidhje me ndërtimin e projektit ose Grantin që mund të vendosen herë pas here nga Pala e Parë.

Neni 13

Paralajmërimet dhe njoftimet

Të gjitha paralajmërimet dhe njoftimet e lidhura me këtë Marrëveshje dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për Fondin e Katarit për Zhvillim:

Adresa: Laffan Tower - 9th floor, West Gulf, Doha

Në vëmendje të: z. Misfer Hamad Al-Shahwani – zëvendësudrejtor i përgjithshëm për projektet e zhvillimit

Telefon: +974 4036 0303

Faks: +974 4036 0316

Email: projects@qatarfund.org.qa

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Në vëmendje të: z. Arben Ahmetaj
Ministër i shtetit për rindërtim

Për Përfituesin:

MSc. Inxh. Henrik Hysenbegasi
Drejtor i Zbatimit të Investimeve të Huaja (PIU)

Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike Sheshi “Skënderbej”

Nd. 2, kodi ZIP 1001, Tiranë, Shqipëri
++355 674045752

henrik.hysenbegasi@tirana.al

Neni 14

Tenderat

Tenderat do të realizohen në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e procedurave të Palës së Parë në lidhje me këtë. Hapja e ofertave do të zhvillohet në Shtetin e Katarit ose në çdo vend të përcaktuar nga Pala e Parë, sipas procedurës së miratuar për hapjen e ofertave nga Pala e Parë. Pala e Parë do të asistohet gjatë këtij procesi nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 15

Shtojcat

Shtojcat në lidhje me planet e ndërtimit të projektit dhe dokumentet e lidhura me të drejtën e përdorimit të tokës së dhënë për ndërtimin e projektit, përveç rezultateve dhe të dhënave të fundit të ekspertëve në lidhje me Projektin, do të bashkëlidhen dhe përbëjnë pjesë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

16.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën përmes kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre ligjore kombëtare të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

16.2 Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme për 36 muaj, duke filluar nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim të lartpërmendur në



lidhje me datën e fillimit dhe do të rinovohet automatikisht nëse Pala e Parë nuk e përfundon këtë marrëveshje.

16.3 Pavarësisht nga vlefshmëria e Marrëveshjes së përmendur në nenin 15.1 më lart, Pala e Parë mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke dhënë një periudhë njoftimi një mujore dhe në këtë rast kjo Marrëveshje çmohet e përfunduar në datën e përfundimit të përcaktuar në njoftim:

16.4 Pala e Dytë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje me miratimin e Palës së Parë dhe pasi t'i kthejë Palës së Parë shumën e plotë të Grantit të përfshirë në këtë Marrëveshje (5,000,000 USD).

Neni 17

Ligji rregullues dhe mosmarrëveshjet

Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni i Shtetit të Katarit.

Neni 18

Në datën _____.2020. Kjo Marrëveshje është nënshkruar në gjuhën angleze, në dy kopje, ndërsa secila Palë mban një dokument origjinal.

Nënshkrimet e Palëve

PËR DHE NË EMËR TË:
**Fondit të Katarit për
Zhvillim**

Z. Khalifa Jassim Al Kuwari
Drejtor i përgjithshëm
Fondi i Katarit për Zhvillim

Pala e Parë

Marrëveshje Granti në lidhje me financimin e rikonstruksionit për 2 shkolla dhe 1 kopsht në Tiranë

REF: GA/QFFD/ALBANIA/016/2020

PËR DHE NË EMËR TË:
**Këshillit të Ministrave të
Republikës së Shqipërisë**

Z. Arben Ahmetaj
Ministër i Shtetit për
Rindërtim

Pala e Dytë

VENDIM

Nr. 775, datë 30.9.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT NGA BASHKIA DURRËS, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTPREVENTIVIT DHE RIFORCIMIN E HIDROVORIT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 51 550 000 (pesëdhjetë e një milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh pa TVSH, për financimin e hartimit të projektpreventivit dhe rforcimin e Hidrovorit të Durrësit, të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020 dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Fondet e mbetura të papërdorura pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” në buxhetin e shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



VENDIM
Nr. 776, datë 30.9.2020

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Gjon Bardhi, drejtor i Përgjithshëm i Doganave, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Genti Gazheli emërohet drejtor i Përgjithshëm i Doganave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM
Nr. 23, datë 28.9.2020

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.
1, DATË 14.1.2020, “PËR
DOKUMENTACIONIN DHE
PROCEDURAT PËR HAPJEN,
RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË
LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE
KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË
STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE
BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË
ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e

institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”,

UDHËZOJ:

1. Në kreun VI, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, pas pikës 5/2, shtohet pika 5/3 me këtë përmbajtje:

“5/3. Përjashtimisht, aplikimet për programet e studimit për vitin akademik 2021–2022, do të pranohen deri më 31 dhjetor të vitit 2020”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 213/1, datë 1.9.2020

**PËR MARRJEN E MASAVE TË
VEÇANTA NGA NJËSITË E
VETËQEVERISJES VENDORE PËR
PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19, PËR APLIKUESIT DHE
PËRFITUESIT E NDIHMËS
EKONOMIKE**

Mbështetur në nenin 116, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, i ndryshuar “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga koronavirusi i ri”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me



qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Aplikimet për ndihmë ekonomike do të realizohen sipas përcaktimit në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër.

2. Punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore pajisen me të gjitha mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart) dhe ruajnë distancën fizike 1.5–2 metra me qytetarët gjatë kryerjes së procedurave për aplikime, deklarime dhe verifikime të situatës social-ekonomike në banesë. Në sportelet e aplikimit për ndihmë ekonomike vendoset mbrojtëse xhami.

3. Në hyrje të institucionit vendoset dezinfektant me bazë alkooli jo më pak se 60% për dezinfektimin e duarve.

4. Pastrimi dhe dezinfektimi i të gjitha ambienteve do të kryhet rregullisht çdo ditë dhe pas çdo hyrje-dalje do të kryhet ajrosja e ambienteve, për jo më pak se 15 minuta, si edhe dezinfektimi i të gjitha sipërfaqeve, mjeteve të punës dhe dorezave të dyerve.

5. Shmangen kontaktet me prekje dhe dhënia e duarve, shmangen prekja e fytyrës, gojës, hundës dhe syve dhe përdorimi i përbashkët apo shkëmbimi i sendeve personale.

6. Për personat që paraqiten për aplikim realizohet matja e temperaturës nga personel që është i pajisur me veshjen e përshtatshme sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

7. Në ambientet e pritjes respektohen rregullat e distancimit social, duke ruajtur distancën prej 1.5–2 m larg njëri-tjetrit dhe merren masa për të evituar grumbullimet masive të tyre gjatë pritjes.

8. Përpara hyrjes në institucion vendoset një shtrojë e lagur me klor/hipoklorit natriumi për të desinfektuar këpucët dhe mjetet ndihmëse të personave me aftësi të kufizuara.

9. Personat që paraqiten për aplikim duhet të jenë të pajisur me mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart).

10. Respektimi rigoroz i masave të distancimit social, rregullave të higjienës, masave parandaluese etj., nuk duhet të shkaktojë mundësi për diskriminim të personave që paraqiten për aplikim për ndihmë ekonomike, deklarim dhe gjatë kryerjes së verifikimeve social-ekonomike.

11. Në ambientet e njësisë së vetëqeverisjes vendore vendosen postera ilustrues të afishuar, postera të larjes dhe dezinfektimit të duarve, si edhe afishohen rregullat e ndryshuara, të cilat do të zbatohen për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

12. Urdhri nr. 213, datë 31.3.2020, shfuqizohet.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR Nr. 266/1, datë 1.9.2020

PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NGA KOMISIONET E VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE INVALIDËVE TË PUNËS PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Mbështetur në nenin 116, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, i ndryshuar, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga koronavirusi i ri”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,



URDHËROJ:

1. Komisionet mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të nivelit të parë dhe epror, të cilat funksionojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimit Social Shtetëror, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë i nivelit të parë dhe Epror, si dhe komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të nivelit të parë dhe të dytë, që funksionojnë pranë Shërbimit Social Shtetëror, të cilat kanë qenë të pezulluara për shkak të epidemisë COVID-19, nisin funksionimin e tyre, duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër.

2. Afatet e parashikuara sipas rregulloreve të Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore të mos aplikohen për periudhën e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë, COVID-19.

3. Anëtarët e komisioneve pajisen me të gjitha mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart) dhe ruajnë distancën fizike 1.5–2 metra nga njëri-tjetri dhe nga personi që paraqitet për vlerësim, për rastet ku komisionet nuk do të kryejnë vlerësim vetëm me dosje dhe është e domosdoshme prezenca e qytetarit.

4. Dezinfektimi i duarve duke përdorur një produkt me bazë alkooli jo më pak se 60% dhe larja e shpeshtë e duarve me sapun dhe ujë të rrjedhshëm për jo më pak se 20 sekonda.

5. Pastrimi dhe dezinfektimi i të gjitha ambienteve të komisioneve do të kryhet rregullisht çdo ditë dhe pas çdo komisionimi do të kryhet ajrosja e ambienteve, për jo më pak se 15 minuta, si edhe dezinfektimi i të gjitha sipërfaqeve, mjeteve të punës dhe të dorezave të dyerve.

6. Shmangien e kontakteve me prekje dhe dhënien e duarve, shmangien e prekjes së fytyrës, gojës, hundës dhe syve dhe përdorimit të përbashkët apo shkëmbimit të sendeve personale.

7. Për personat që paraqiten për vlerësim realizohet matja e temperaturës nga personel që është i pajisur me veshjen e përshtatshme sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

8. Në ambientet e pritjes jashtë zyrës së vlerësimit, respektohen rregullat e distancimit social gjatë kohës që personat presin për të kryer procedurën e vlerësimit, duke ruajtur distancën prej

1,5–2 m larg njëri-tjetrit, dhe merren masa për të evituar grumbullimet masive të tyre gjatë pritjes, duke përcaktuar datat dhe oraret e vlerësimit për çdo rast.

9. Përpara hyrjes në institucion vendoset një shtrojë e lagur me klor/hipoklorit natriumi për të dezinfektuar këpucët dhe mjetet ndihmëse të personave që do të paraqiten në komision.

10. Personat që paraqiten për vlerësim duhet të jenë të pajisur me mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart).

11. Respektimi rigoroz i masave të distancimit social, rregullave të higjienës, masave parandaluese etj., nuk duhet të shkaktojë mundësi për diskriminim të personave që paraqiten pranë komisioneve për vlerësim.

12. Në ambientet e komisioneve vendosen postera ilustrues të afishuar, postera të larjes dhe të dezinfektimit të duarve, si edhe afishohen rregullat e ndryshuara, të cilat do të zbatohen për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

13. Mjekët e komisionit në çdo rast të dyshuar ndjekin protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Institutit të Shëndetit Publik.

14. Anëtarët e komisioneve mjekësore janë të detyruar të mos bëhen pjesë e mbledhjes nëse nuk ndjehen mirë ose nëse kanë simptoma të ngjashme me ato të infektimit të COVID-19 dhe njoftojnë drejtuesin e institucionit nëse janë apo kanë pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv me COVID-19.

15. Urdhri nr. 226, datë 2.4.2020, shfuqizohet.

16. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës të nivelit të parë dhe epror.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



URDHËR

Nr. 294, datë 29.9.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Autorizimin e drejtorit të përgjithshëm, z. Alqi Kushi, për të nënshkruar autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në emër të nëpunësit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha gjykatat dhe shkallët e gjykimit, si dhe aktet, duke përfshirë dhe pa u kufizuar, kërkesëpadi, kërkesë penale, kallëzime penale, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të çështjeve, si dhe t'i nënshkruajë ato.

2. Data e fillimit të kompetencave të deleguara është data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Alqi Kushi, drejtor i përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

VENDIM

Nr. 149, datë 10.9.2020

**MBI MIRATIMIN E “PROGRAMIT TË
PËRPUTHSHMËRISË
RREGULLATORE/ REGULATORY
COMPLIANCE PROGRAMME”,
PARAQITUR NGA TAP-AG NË BAZË TË
“OPINIONIT TË PËRBASHKËT
PËRFUNDIMTAR/FINAL JOINT
OPINION” NË KUADËR TË
PROCEDURËS SË PËRJASHTIMIT
PËR GAZSJELLËSIN TAP**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 13, 15, 16 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP-AG,

konstatoi se:

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.2.2014, në zbatim të:

- direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim “Direktiva 73/09”);

- rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009, e cila themelon agjencinë për bashkëpunim midis rregullatorëve të energjisë;

- rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009, në lidhje me kushtet e hyrjes në rrjetet e transportit të gazit natyror, e cila shfuqizon rregulloren e KE-së 1775/2002;

- ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

- vendimit nr. 27, datë 1.3.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe



(10), të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”;

- vendimit të Komisionit Evropian C (2013) 2949, të datës 16 maj 2013, mbi “Përfundimin e tubacionit Trans Adriatik nga kërkesat për hyrjen e palës së tretë, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, të përcaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10), të direktivës 2009/73/EC, “Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on third party access, tariff regulation and ownership unbundling laid down in Articles 9, 32, 41(6), 41(8) and 41(10) of Directive 2009/73/EC”;

- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013), të datës 14 maj 2013; Republika e Shqipërisë, Enti Rregullator i Energjisë, Bordi i Komisionerëve;

- vendimit nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 1.3.2013 ‘Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian (C(2013)2949” nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinionit i Përbashkët Përfundimtar i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP-AG për Përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)”/“Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP-AG’s Exemption Application Autorita për l’Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjisë (Albania) dhe Regulatory Authority of Greece (Greece)”, në vijim “Final Joint Opinion”;

- vendimit nr. 127, datë 7.11.2013 “Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP-AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion” në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP;

- kërkesës së TAP-AG, të datës 8 janar protokolluar prej ERE-s me nr. 56 prot., datë 14.1 2014;

- kërkesës së TAP-AG, datë 5 shkurt 2014 (prot. hyrës nr. 56/1, datë 8.2.2014), për miratimin e draftit final të “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, i dorëzuar më parë më 15 nëntor 2013 (nr. protokoli hyrës 500/19). E njëjta kërkesë i është paraqitur njëkohësisht dhe në të njëjtën formë edhe autoriteteve rregullatore të Italisë (AEEG) dhe të Greqisë (RAE);

- komunikimit më datë 8 shtator 2020, me të cilin TAP-AG ka vënë në dispozicion të autoriteteve programin e pajtueshmërisë të përgatitur në përputhje me vendimin e certifikimit dhe ka treguar kandidatin për emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë.

Duke konsideruar që:

- Shoqëria TAP-AG ka paraqitur në ERE, në përputhje me ligjin nr. 102/2015, datë 23.9.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, kërkesën për përjashtim në lidhje me projektin e një interkonjeksi qe kalon nga Greqia dhe Shqipëria për të vijuar në Itali (në vijim “Gazsjellësi TAP”) dhe si të tillë për efekt të përjashtimit është e nevojshme përfshirja edhe e autoriteteve rregullatore (në vijim “autoritetet”) për Greqinë, Enti Rregullator i Energjisë (në vijim “RAE”) dhe për Italinë Autoriteti për Energjinë Gazin dhe Ujërat (në vijim “AEEG”);

- kjo kërkesë përfshinte, ndër të tjera, përjashtimin nga neni 9.1 i direktivës së gazit (2009/73/EC) (në vijim “përjashtim nga kushti për ndarjen pronësore”);

- ERE, me vendimin nr. 27, datë 1.3.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendosi “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10), të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”;

- me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s miratoi amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 1.3.2013 “Miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG” prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10), të direktivës 2009/73/EC, për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian C(2013)2949”, nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinion Përfundimtar i Përbashkët i



Rregullatorëve të Energjisë” mbi aplikimin e TAP-AG për përjashtim;

- paragrafi 4.5, i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion përjashton TAP-AG nga detyrimi i ndarjes pronësore për një periudhë prej 25 vjetësh nga momenti i vënies në funksionim të infrastrukturës gazsjellëse;

- gjithashtu, paragrafi 4.5.1, i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion e detyron TAP-AG të vendosë në zbatim *unbundling* funksional përpara se të alokojë kapacitetet si rezultat i fazës së parë të prenotimit (*First Booking Phase*), të parashikuar më 17 mars 2014, siç komunikuar nga TAP-AG në shkresën e datës 8 janar 2014.

- **Në mënyrë të veçantë, paragrafi i sipërcituar i Final Joint Opinion e detyron TAP-AG, të:**

1. zhvillojë një “Program të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, i cili duhet të paraqitet për miratim në të tre rregullatorët, me qëllim për të garantuar trajtimin e barabartë të pjesëmarrësve në *Booking Phase* dhe për të parandaluar rrjedhjen e informacionit me interes tregtar ndaj aksionerëve;

2. përcaktojë një person që do të jetë përgjegjës, Oficeri i Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Officer (RCO), jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të Programit të Përputhshmërisë nga Rregullatorët.

- **Gjithashtu, paragrafi i sipërcituar parashikon se “Programi i Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, duhet të përcaktojë të paktën:**

a) masat e ndërmarra për të garantuar trajtimin e barabartë të pjesëmarrësve në fazën e prenotimit/*Booking Phase* të parë;

b) detyrimet që duhet të përmbushin nëpunësit e TAP-AG, me qëllim për t’u përmbajtur programit të sipërcituar;

c) personin dhe organin përgjegjës për të kontrolluar programin e përputhshmërisë dhe prezantimit të një raporti vjetor mbi masat e miratuara nga rregullatorët;

d) parimet që lidhen me metodologjinë e tarifave dhe rregullave të menaxhimit të kapaciteteve të komercializuara nga TAP-AG;

- referuar specifikisht shkronjës “d” më sipër, programi në fjalë, nga njëra anë, rinovon parimet e metodologjisë së tarifave të përcaktuara në TAP

Tariff Code (miratuar nga ERE me vendimin nr. 127, datë 7.11.2013) dhe, nga ana tjetër, përcakton që rregullat e menaxhimit të kapaciteteve do të jenë objekt i Kodit të Rrjetit, që në bazë të paragrafit 4.7, pika 1, të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion, TAP-AG do të paraqesë për miratim nga rregullatorët jo më vonë se 1 vit para vendosjes në punë të infrastrukturës gazsjellëse;

- së fundi, paragrafi 4.5, pika 2, i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion, parashikon që TAP-AG të certifikohet në cilësinë e Operatorit të Pavarur të Transmetimit (ITO) para vendosjes në punë të infrastrukturës gazsjellëse, por jo më vonë se 1 janari 2018;

- në datën 5 shkurt 2014, shoqëria TAP-AG, në përputhje me paragrafin 4.5, pika 1, të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion ka paraqitur një propozim të programit të përputhshmërisë, drejtuar enteve ERE, AEEG dhe RAE, me qëllim për të siguruar aprovimin e këtij programi.

Duke vlerësuar që:

- Programi i Përputhshmërisë Rregullatore është konform përcaktimeve të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion të evidentuara më lart (shkronjat “a”-“d”) dhe se parashikon, ndër të tjera, që çdo ndryshim i mundshëm në përmbajtjen e tij është objekt i miratimit nga ana e rregullatorëve;

- i njëjti qëndrim është ndarë dhe mbajtur dhe nga ARERA dhe RAE;

- është i nevojshëm miratimi i programit të përputhshmërisë së propozuar sipas paragrafit 4.5, të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për të garantuar trajtimin e barabartë të pjesëmarrësve në fazën e prenotimit/*Booking Phase* të parë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, të propozuar nga TAP-AG, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Njoftimin e autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë (ARERA) dhe të Greqisë (RAE) dhe të TAP-AG, për marrjen e këtij vendimi.



3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 150, datë 10.9.2020

**MBI DISA SHTESA NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 105/2020,
MIRATIMIN E OFICERIT TË
PËRPUTHSHMËRISË (ZP) SË TAP
DHE KONTRATËS PËR OFRIMIN E
SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË
PËRPUTHSHMËRISË**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 5, germa “c”, të “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin dhe draftin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror për miratimin e oficerit të përputhshmërisë (ZP) të TAP-së, konstatoi se:

Duke pasur parasysh që:

- Me vendimin e Bordit të ERE nr. 105/2020 është vendosur për miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) të TAP-së dhe të kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë.

- Në datën 15.9.2020, Autoriteti Rregullator i Italisë, ARERA, miratoi kandidatin e propozuar nga TAP AG, si Zyrtar i Pajtueshmërisë.

- Në datën 17.9.2020, Autoriteti Rregullator i Greqisë, miratoi kandidatin e propozuar nga TAP AG, si Zyrtar i Pajtueshmërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105/2020, si më poshtë:

Në konstatimet e vendimit nr. 105/2020 shtohen:

“- Duke pasur parasysh komunikimin e datës 8 shtator 2020, ku TAP vendosi në dispozicion autoriteteve, RAE, ARERA dhe ERE, një program të ri të pajtueshmërisë, i cili është i integruar me masat e vendosura mbi të, nga vendimi i certifikimit dhe tregoi kandidatin e ri për rolin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë me disa shtesa të cilat u pasqyruan në të;

- Dokumenti i sipërpërmendur përmban, ndër të tjera, masat për të siguruar pavarësinë e menaxhimit dhe stafit të kompanisë, si dhe masat e vendosura për të siguruar përpunimin e informacionit të ndjeshëm tregtar;

- Duke pasur parasysh se kandidati për rolin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë i rekomanduar nga TAP AG, bazuar në dokumentacionin e siguruar, posedon kushtet e nevojshme të pavarësisë dhe profesionalizmit të parashikuara nga rregulloret në fuqi.”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 151, datë 18.9.2020**

**MBI ZGJATJEN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“LENGARICA & ENERGY” SHPK, NR.
306, SERIA FK15, PËR RINOVIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s,
NR. 105, DATË 18.8.2015**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 8, nenit 9, nenit 13, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/2 prot., datë 7.9.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 134, datë 10.8.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/22 prot., datë 11.8.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta,

lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 947/1 prot., datë 13.8.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k. me shkresën nr. 31 prot., datë 20.8.2020, protokolluar në ERE me nr. 974/2, datë 21.8.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar me përjashtim të Sistemit IT dhe disponimit të zyrave të dedikuara për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 974/3 prot., datë 28.8.2020, në bazë të nenit 11, të rregullores së licencimit iu kërkua shoqërisë të paraqesë në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj edhe nga rrethi i Përmetit.

- Në përgjigje të sa kërkuar nga ERE, shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 974/4 prot., datë 1.9.2020, dhe shkresës nr. 974/5 prot., datë 3.9.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.

- Në vijim të situatës së krijuar nga Covid-19, në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 133, datë 10.8.2020, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, është përcaktuar se afati për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence për të gjitha licencat që kanë përfunduar deri në 30 qershor 2020, është jo më vonë se data 1.9.2020.

- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. rezultoi i paraqitur në afat.

- Rezulton se shoqëria ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacionit për aplikim (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Mungon dokumentacioni i kërkuar sipas germës “e” (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).

Mungon dokumentacioni i kërkuar sipas germës “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve).

- Referuar dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe informacionit të përcjellë për qëllime të këtij aplikimi rezulton e paqartë se si do të sigurohet energjia për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit nga shoqëria aplikuese.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes së ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 152, datë 18.9.2020

MBI ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “MOBIGAS ALBA” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/5 prot., datë 11.9.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 8.6.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 62/16 prot., datë 10.6.2020, ka kryer njoftimin në medien e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 723/3 prot., datë 19.6.2020, ERE ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar apo atij të konsideruar si i nevojshëm/shtesë në kuadër të aplikimit.

- Dokumentacioni, i cili u konstatua në mungesë apo për plotësim, konsiston si vijon:

**Neni 9, pika 1. Forma e aplikimit**

i. Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë tregtare që nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.

xi. Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritët në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për Aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore, sipas rastit për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse.

Germa “e”. Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale

Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre vjetëve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit.

vi. Një plan biznesi, i cili përfshin një analizë të kostove dhe të përfitimeve, përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve.

2. Dokumente specifike për llojin e licencës

Licenca për tregtimin e gazit natyror duhet të përmbajë informacion të përgjithshëm, që përfshin:

ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe, në veçanti, për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.

- Pas depozitimit të dokumentacionit nga ana e shoqërisë, përkatësisht me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 723/7 prot., datë 13.7.2020, nr. 723/8 prot., datë 17.7.2020, nr. 697/17 prot., datë 24.7.2020, si dhe nr. 723/10 prot., datë 12.8.2020, ka rezultuar se ka mbetur ende dokumentacion/informacion pa plotësuar, si vijon:

- **Germa “d”.** Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor

vi. Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritët në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për

aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore, sipas rastit për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse – plotësuar pjesërisht.

- **Germa “e”.** Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale

ii. Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese të akredituar, për secilin prej tre vjetëve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit – plotësuar pjesërisht.

vi. Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve – plotësuar pjesërisht.

- Dokumente specifike për llojin e licencës

ii. Garancinë që cilësia e tregtimit të gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit – pa plotësuar.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe, në veçanti, për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit – plotësuar pjesërisht.

- Edhe pse shoqëria ka depozituar dokumentacion e informacion për çdo kërkesë të rregullores, rezulton që dokumentacioni nuk është ende i plotësuar tërësisht sipas kërkesave specifike të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Megjithatë shoqëria ka treguar vullnetin dhe angazhimin saj për të plotësuar çdo kërkesë të rregullores, është e nevojshme më shumë kohë, për vijimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kësaj kërkesë, si dhe vlerësimin e kompetencës lëndore të ERE-s mbi këtë kërkesë.

- Në mbështetje të nenit 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ERE ka kompetencën të shqyrtojë dhe të shprehet në lidhje me kërkesën për shtyrjen e afatit të një procedure nën autoritetin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 153, datë 18.9.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “M.T.C. ENERGY” SHPK, “PËR BARRËSIMIN DHE HIPOTEKIMIN E ASETVE TË SHOQËRISË ‘M.T.C. ENERGY’ SHPK NË HEC ‘RADOVË’, NË FAVOR TË ‘ALPHA BANK’, NË ZBATIM TË KONTRATËS SË HUAS ME ‘ALPHA BANK’ SHA NR. 125 REP., NR. 32 KOL, DATË 9.1.2020”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikat 1.3, të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/6 prot., datë 11.9.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k., për transferimin e aseteve të saj nga “Raiffeisen Bank” sh.a. tek “Alpha Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 107, datë 2.7.2020, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C.

Energy” sh.p.k., për transferimin e aseteve të saj nga “Raiffeisen Bank” sh.a. tek “Alpha Bank” sh.a.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 679/4 prot., datë 7.7.2020, ERE i drejtua shoqërisë duke i kërkuar saktësimin e objektit të kërkesës për të orientuar sa më saktë vendimmarrjen finale të ERE-s. Gjithashtu, shoqërisë iu kërkuua plotësimi i dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 679/6, datë 24.7.2020, ka përcjellë shpjegimet e saj dhe dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “MTC Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 679/8, datë 8.9.2020, ka saktësuar objektin e kërkesës së saj, në “Kërkesë për miratimin nga Bordi i ERE-s për barrësimin dhe hipotekimin e aseteve përkatëse të shoqërisë ‘M.T.C Energy’ sh.p.k. në HEC ‘Radovë’, në favor të ‘Alpha Bank’, në zbatim të kontratës së huas me ‘Alpha Bank’ sh.a. nr. 125 Rep, nr. 32 kol., datë 9.1.2020”.

- Pas saktësimit të objektit të kërkesës, ERE vlerëson se kjo kërkesë është objekt shqyrtimi nga ERE.

- Shoqëria “M.T.C. Energy” sh.p.k. është një shoqëri koncesionare e krijuar në bazë të Kontratës së Koncesionit nr. 680 rep., dhe nr. 87 kol., datë 9.3.2009, të formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit në përfundim të kontratës së koncesionit tek Autoriteti Kontraktues), të nënshkruar me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, për ndërtimin e hidrocentralit “Radovë”.

- Kjo shoqëri është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, më datë 24.3.2009, në përputhje me kontratën e koncesionit, dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe objekti i veprimtarisë së saj është: “Ndërtimi, operimi dhe transferimi i HEC-it “Radovë” tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihen: financimi, ndërtimi dhe vënia në punë, prodhimin, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në zbatim të kontratës së koncesionit nr. 680 rep., nr. 87 kol., datë 9.3.2009.

Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në rregulloren për



procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” “f”, “g” “h” “i” dhe “j” janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3 (subjektet koncensionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e organit shtetëror të autorizuar (MEI), në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve). Plotësuar. Me shkresën nr. 8357/1 prot., datë 25.10.2019 të MIE-s, aplikuesi ka marrë miratimin për vëdoje hipoteke, peng apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve, si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo palë financuese, me kusht që hipoteka , peng apo barra tjetër, si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të koncesionarit në këtë kontratë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për barrësimin dhe hipotekimin e aseteve fikse dhe që i shërbejnë aktivitetit të licencuar të shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k. në HEC “Radovë”, në favor të “Alpha Bank”, në zbatim të kontratës së huas me “Alpha Bank” sh.a. nr. 125 rep., nr. 32 kol., datë 9.1.2020” (bashkëlidhur lista e aseteve).

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



ASETET E HEC RADOVË

Nr.	EMËRTIMI	NJËSIA	SASIA	SHËNIME
I	Godina e Hidrocentralit 24.50 m x 13.40 m=328.30 m ² . Seksioni i dyte eshte salla e transformatoreve çelave me permasa 24.50 m x 4.20 m=102.90 m ² . Sipërfaqja e përgjithshme eshte 328.30 m ² + 102.90 m ² =431.20 m ²	m2	380	
1	Hidroturbina Pelton 1397 Kw (P=1397 Kw H=152m Tipi: HLA520-WJ-100; Q=2.1 m ³ /sek Nr. rrot.= 600 rrot/min Nr. Serisë --; datë (SIEMENS)	copë	2	
2	Gjeneratorë (SIEMENS) P=4300 Kw Tipi: SFW4300-8-1730 6300V; 463.6A; 50Hz Faktori Fuqisë 8.85; Lidhja Yll Nr. serisë 10315	copë	2	
	Unit power e lubrifikimit			
3	Valvolat Flutur Pjesët ndihmëse te valvoles Reagimi per 2 sek	copë	2	
	Vinc ure 12.5 ton	cope	1	
II	MBROJTJA	unit	1 x 2	
	Panel Gjeneratori/komandimi (SIEMENS)	copë	2	
	Paneli mbrojtjeve (SIEMENS)	copë	2	
	Paneli Eksitimit (SIEMENS)	copë	1	
	Paneli Sinkronizimit (SIEMENS)	copë	2	
III	CELAT	unit	1 x 2	
	Cela linjes 10 kV (SIEMENS)	copë	1	



	Cela matjes 10 kV (SIEMENS)	copë	2	
	Cela e Gjeneratorit (SIEMENS)	copë	1	
	Cela transformatorit n.v.10kV (SIEMENS)	copë	2	
	Panel komandimi në distancë (SIEMENS)	copë	2	
	Paneli i nivelit të basenit	copë	1	
	Paneli i shpërndarjes AC/DC (SIEMENS)	copë	1	
	Rrufepritëse	copë	0	
	Tokëzimi	unit	1	
IV	TRANSFORM. KONS. VETIAK	unit	6	
	Transformator Kons. veti. 100 kVA	copë	1	
	Transformator fuqie 2000kVA (SIEMENS)	copë	2	
VI	LINJA 10KW	unit	4 500	
	Shtylla çeliku	copë	4	
	Shtylla betoni 12 ml	copë	108	
	Linje kabllore 10 kv	ml	2 225	
	Linja e tensionit 10 KV	ml	4 500	
	Kabull elektrik	ml	2 500	
	Fibër optike	ml	2600	
VII	KANALET E DERIVACIONIT			
	Kanal derivacioni 1.8x4 m	ml	40	
	Kanal shkarkimi 1.8x4 m	ml	70	
	Tunel 2.5 0x 2.30 m	ml	640	
VIII	VEPRAT E MARRJES			
	Vepra e Marrjes Nr.1	copë	1	
	Përmasat janë (9x1.7) m.			
	Vepra e Marrjes Nr.2.	copë	1	
IX	DEKANTUESI	unit	2	



	Dekantuesi Nr1	copë	1	
	Dekantuesi Nr2	copë	1	
	BASANI I PRESIONIT			
	Baseni i Presionit Nr.1			
	Baseni i Presionit Nr.2			
XI	PENSTOCK-U			
	Tubi GRP D1200 & D1300 mm	ml	1443	
	Tubacion Celiku D800& D 1300/1200	ml	749.7	
	Ankera	copë	11	
	Porta metalike	cope	8	
	Tokë truall në pronësi	m2	1690	
	Tokë me qera	m2	8630	
	Rrugët e shërbimit	ml	5500	

Tabela 1: Asetet e HEC Radovë

Tabela 1: Asetet e Instaluar ne Godine HEC Radovë

Emërtimi	Marka	Çmimi	Lloji	Kodi i artikullit	Nr. serial	Viti
Turbina 1	Koessler	325000	Pelton	84109000	5298	2013
Turbina 2	Koessler	325000	Pelton	84109000	5298	2013
Gjenerator 1	Hitzinger	143500	Vertikal	85016400	139868	2013
Gjenerator 2	Hitzinger	143500	Vertikal	85016400	139868	2013
Pajisje të tensionit të mesëm	Siemens	86000	Tre fazor	85372091	-----	2013
Pajisje të tensionit të ulët	Siemens	103000	Tre fazor	85372091	-----	2013
Transformatori 1	Siemens	40000	Tre fazor	85043400	85892	2014
Transformatori 2	Siemens	40000	Tre fazor	85043400	85892	2014
Transformatori 3	Siemens	7000	Tre fazor	85043300	85892	2014
Vinc 12 Ton	-	12000				2013

1213000



TABELA E VLERËSIMIT IMEDIAT TË ASETEVE TË HEC RADOVË

Nº	Embarcación / avaria	Stano	Verificación	Tipología	Steel	From production	Modelo	Nº. l. fabricación	Número	Características Técnicas	Via producción	Via consumo	Volumen de negocio (MILL.)	Volumen de negocio (MILL.)
1	Sable e aggregates	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	2308	BLI	Grados e control	2013	2014	91.129.992.20	84.730.992.20
2	Hidráulicos P-200	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
3	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
4	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
5	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
6	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
7	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
8	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
9	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
10	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
11	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
12	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
13	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
14	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
15	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
16	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
17	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
18	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
19	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
20	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
21	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
22	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
23	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
24	Grados e control	2	Grados e control	PO	Grados e control	PO	Grados e control	1.308.65	BLI	Grados e control	2013	2014	41.840.940.0	38.910.007.20
SUDMA TOTALE														

**Përroi i Çarshovës**

- 1- Vepra e Marrjes Nr.1
- 2- Kanali Derivacionit L= 40 ml
- 4- Baseni i Dekantimit

Përroi i Postenanit

- 1- Vepra e Marrjes Nr.2
- 2- Baseni i Dekantimit
- 3- Kanali Derivacionit L= 70ml

Bashkimi i dy Përrenjeve

- 1- Tunel 2.7x2.7 m 640 ml
- 2- Tubi GRP D1200 & D1300 mm : L=1442.50 ml
- 3- Tubacion Çeliku D1200/1100/800 mm L=786.70 ml
- 4- Linja Elektrike e Trasmetimit të Energjisë 10 kv (L= 4 500 ml me 4 cope shtylla metalike dhe 12 shtylla betoni)
- 5- Godinës së Agregateve me sipërfaqe totale: 328.30 m^2 · Godina e Hidrocentralit 24.50 m x 13.40 m= 328.30 m^2 . Seksioni i dyte eshte salla e transformatoreve çelave me permasa 24.50 m x 4.20 m= 102.90 m^2 . \Sipërfaqja e përgjithshme eshte $328.30 \text{ m}^2 + 102.90 \text{ m}^2 = 431.20 \text{ m}^2$
- 6- Agregatet Teknologjike (Turbina copë-2; Gjeneratorë copë-2; Vinç 12.5 Ton-copë-1)
- 7-Kanali i shkarkimit l=70 ml

Fuqia e kapacitive të turbinave të instaluar në HEC Radovë është :2 x 1397 =2794 KW
--

ÇËSHTJET MBI BARRËN E PRONËSISË

Sipas dokumentave kocesioni disponon këto çertifikata të pasurive të paluatshme:

- 1- Nr. Pasurie 452/4 ND –Zona kadastrale Nr. 3034 me emërtim "MTC ENERGY" me sipërfaqe 380 m2 (referuar çertifikatës së Pronësisë Nr. 968389. datë 10.06.2015)
- 2- Nr. Pasurie 452/3 ND –Zona kadastrale Nr. 3034 me emërtim "MTC ENERGY" me sipërfaqe 450 m2 (referuar çertifikatës së Pronësisë Nr.968391. datë 10.06.2015)
- 3- Nr. Pasurie 106/1 ND – Zona kadastrale Nr. 3144 me emërtim Ndërtese me sipërfaqe 860 m2 (referuar çertifikatës së Pronësisë Nr.968392. datë 10.06.2015)



VENDIM

Nr. 154, datë 18.9.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “KAMICAN” ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1860 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/1 prot., datë 7.9.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamican”, me kapacitet të instaluar 1860 kW,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1073 prot., datë 1.9.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 6.3.2006, konform legjislacionit përkatës dhe mban statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., ka mes të tjerave: Ndërtim hidrocentralesh dhe shitje me shumicë e pakicë të energjisë elektrike.

- Kontrata nr. 621 rep., nr. 116/3 kol., datë 21.5.2020, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Kamican’ me kapacitet 1860 kW, në përroin e Kamicanit dhe përroin e Bistës, me derdhje në lumin Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit “IDI 2005”

sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj pas nënshkrimit nga palët.

- Shoqëria ka depozituar në ERE Raportin e Oponencës Teknike (OT) të kryer për projektin e zbatimit të HEC “Kamican”, dërguar nga AKBN-ja, me shkresën e saj nr. 4362/4 prot., datë 31.7.2017, dhe të miratuar nga MIE me miratimin përfundimtar nr. 3157/1 prot., datë 16.4.2020. Ky raport i OT konkludon se projekti i zbatimit për ndërtimin e HEC “Kamican” plotëson kushtet teknike dhe standardet e projektimit.

- Shoqëria ka depozituar në ERE miratimin përfundimtar të MIE-s dhënë me shkresën nr. 3157/1 prot., datë 16.4.2020, për ndërtimin e HEC “Kamican” me kapacitet prodhues 1860 kW, në përroin e Kamicanit dhe përroin e Bistës, me derdhje në lumin Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka depozituar në ERE kontratën e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, me nr. 1322 prot., datë 28.2.2018, e lidhur midis Bashkisë Elbasan, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit. Gjithashtu shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka depozituar në ERE edhe kontratën e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” me nr. 7126 prot., datë 10.12.2017, e lidhur midis Bashkisë Gramsh, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka përcjellë në ERE “Miratimin për pikë lidhje për HEC ‘Kamican’ me nr. 440/1 prot., datë 23.1.2019, nga i cili rezulton se HEC “Kamican”, me kapacitet të instaluar 1680 kW, do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes në zbarat 35 kV në n/stacionin Gramsh.

- Shoqëria ka depozituar në ERE “Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. 1196 prot., datë 30.10.2018, të miratuar nga KBU Seman, me vendimin nr. 18, datë 25.10.2018, për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., me qëllim përdorimin e burimit të ujit për prodhim energjie.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE “Vendim për VNM-në paraprake”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 614 prot., datë 11.2.2020, me nr. 7 vendimi, për personin juridik “IDI 2005” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ‘Ndërtim i HEC ‘Kamican’”.



- Aplikimi i shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar nga rregullorja sipërcituar, rezulton si në vijim:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”). Plotësuar në mënyre korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2. – (Vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB), do t’i kërkohej shoqërisë depozitimi i certifikatës së regjistrimit. (Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria), në vijim, në zbatim të nenit 11, të rregullores së licencimit (dokumentacioni shtesë), do t’i kërkohej të depozitojë në ERE edhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë nga rrethet gjyqësore ku ka selitë, për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3. - Neni 9, pika 3, germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin bankar. Do t’i kërkohej ta përcjellë të rifreskuar vërtetimin bankar, si dhe dokumentacioni për mbështetjen financiare për ndërtimin e veprës referuar vlerës së investimit në kontratë.

- Dokumentacioni teknik për HEC.

Neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin. Do t’i kërkohej shoqërisë të plotësojë emërtesën e prodhuesit të transformatorit.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik. Plotësuar.

Neni 9, pika 4.1.4, germa “a” (Studimi i fizibilitetit).

Neni 9, pika 4.1.4, germa “b” (Grafiku i zbatimit të projektit).

Neni 9, pika 4.1.4, germa “d” (Plani i biznesit).

- Leje nga institucione të tjera.

Neni 9, pika 4.1.5, germa “a”, (Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes). Konstatohet se kapaciteti i HEC, i pasqyruar në këtë miratim (1680 kW), është i ndryshëm nga ai i kontratës me MIE-n (1860 kW). Do t’i kërkohej shoqërisë ta saktësojë atë me kontratën me MIE-n dhe ta përcjellë edhe njëherë në ERE të saktësuar

miratimin për pikën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.

Neni 9, pika 4.1.5, germa “b” (Leje e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike). Plotësuar.

Neni 9, pika 4.1.5, germa “c” (Leje mjedisore). Në VNM-në paraprahe konstatohet se kapaciteti i HEC, i pasqyruar në të (1680 kW) është i ndryshëm nga ai i kontratës me MIE-n (1860 kW). Do t’i kërkohej shoqërisë ta saktësojë atë me kontratën me MIE-n dhe ta përcjellë edhe njëherë në ERE me saktësimet në lidhje me VNM-në paraprahe.

Për dokumentacionin shtesë apo atë të munguar, do të njoftohet aplikuesi që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamican”; me kapacitet të instaluar 1860 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasja Migena Maliqaj, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Anri Maliqaj, i datëlindjes 20.2.1982.

KËRKUESE
Migena Maliqaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë